

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për shtyp

Mbi

Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises SA

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 26.06.2009 miratoi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100% të aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë tek shoqëria Anika Enterprises S.A.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit, vërejtë se në bazë të transaksionit të realizuar, Anika Enterprises përfiton kontrollin e plotë nëpërmjet transferimit të 100% të kapitalit aksionar nga shoqëria Banka e Kreditit të Shqipërisë.

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises SA është ndryshim kontrolli dhe nuk ndryshon strukturën e tregut bankar.

Palët në përqendrim kanë pjesëmarrje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në disa shoqëri që ushtrojnë veprimtari në tregje të ndryshme nga tregu bankar dhe nuk kanë klientë të përbashkët. Nga analiza e konkurrencës nuk ka tregje të prekura nga përqendrimi i njoftuar. Gjithashtu, Banka e Kreditit të Shqipërisë ka një pjesë të vogël të tregut bankar shqiptar.

Për sa më lart, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të plotë të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë pas përqendrimit.

Për këto arsye, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës **vendosi të autorizojë përqendrimin** e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të kapitalit aksionar të Bankës së Kreditit të Shqipërisë tek shoqëria Anika Enterprises SA.